



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:171143

Datë: 23.11.2022

Numri i dokumentit: 03680081

P.nr. 2021:171143

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues **Mizahir Shabani**, me bashkëpunëtorin profesional **Samir Morina**, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga Rahoveci, Rr. “Sh. M.”, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 3 nënparag. 3.1 dhe nënparag. 3.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm, PP/II.nr.1047/2021 më datë 30.07.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Mone Syla dhe të akuzuarit, më datë **15.11.2022**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. M., nga i ati H. dhe e ëma Rr., e lindur B., i lindur më ... në Rahovec, ku edhe tani jeton, me nr. personal ..., i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Ekziston dyshimi i bazuar se:

Me datë 12.07.2021, rreth orës 11:00 minuta, në Rr. “Sh. M.” në Rahovec, në shtëpinë e tyre i pandehuri B. M., ushtron dhunë në familje, respektivisht keqtrajtim fizik ndaj anëtarit të familjes duke e sulmuar fizikisht të dëmtuarin – babanë e tij H. M., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të mëhershme që kishin mes vete, i pandehuri vazhdimisht kërkon para nga prindi i tij, ku i revoltuar e ka për fyti dhe me dorë e shtynë duke e rrëzuar nga karrigia, me ç’rast tek i dëmtuari ka shkaktuar dhembje dhe shqetësim.

-Me çka ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 3 nënparag. 3.1 dhe nënparag. 3.2, lidhur me parag. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 6, 7, 17, 38, 46 parg. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nga neni 248/3-3.1.3.2-1 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

DËNIMIN ME KUSHT - Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari H. S. M. nga Rahoveci, udhëzohet që kërkesën pasurore – juridike, mund ta realizoj në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) Euro, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumë prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1047/2021 të datës 30.07.2021, kundër të akuzuarit B. M. nga Rahoveci, Rr. “Sh. M.”, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 parg. 3 nënparag. 3.1 dhe nënparag. 3.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.11.2022, prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Mone Syla, dhe i akuzuari, nuk ka qenë prezent i dëmtuari për të cilin gjykata ka prova se është ftuar me kohë dhe në rregull, por mungesën e vet nuk e ka të arsyetuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj.

I akuzuari B. M., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ndien veten fajtor për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtun gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, i propozoj gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit, pasi që jam i gjendjes së varfër ekonomike e i papunësuar.

Prokurori i shtetit Mone Syla, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B. M., pasi që pranimi i fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë, po ashtu se fakti i pranimin të fajësisë gjen mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favorët dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu duke marr për bazë në të cilat është paraqitur gjendja faktike në diapozitivin e saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për

të cilat ngarkohet i akuzuari. Dhe se provat të cilat janë të ligjshme, andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të njëjti ti shqiptojë një dënim të paraparë ligjor, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet, gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të llojit dhe dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe posaçërisht ato rënduese të parapara për faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënieve familjare.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 paragraf. 3 nënparagraf. 3.1 dhe nënparagraf. 3.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 248 paragraf. 3 nënparagraf. 3.1 dhe nënparagraf. 3.2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Dhuna në familje: **“Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet; nënparagraf. 3.1. “Marrëdhënia familjare” për nevojat e kësaj dispozite është në përputhshmëri me përkufizimin në nenin 113 të këtij kodi; nënparagraf. 3.2. Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e këtij kodi do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje”.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues.

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin, e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale dhuna në familje nga neni 248 paragraf. 3 nënparagraf. 3.1 dhe nënparagraf. 3.2 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës

së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte e të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se ndjen keqardhje për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

E dëmtuara ka nuk ka parashtruar kërkesë për realizimin e kërkesës pasurore – juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 453 parg. 4 të KPPK-së. Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,
P.nr. 2021:171143, me datë 18.11.2022.**

**B. Profesional
Samir Morina**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.